




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJES



Nr. 6761 Prot.

Vau Dejës, më 29/10 2019

V E N D I M

Nr. 74, datë 25.10.2019

Për

**Miratimin e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor/kullosor për depozitim Materiale inerte (Zhure) në objektin Kosmaç**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 25.10.2019, dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, mbështetur në nenin 9 pika 1.2, germa a dhe c ,nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e”, neni 55,pika 4 dhe 6 ,nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 19 pikat 1’1/1 e ligjit nr. 9385 date 04.05.2005 “Për fondin pyjor“ i ndryshuar”, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” pikat 3,4 të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.7.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” ,Këshilli pas miratimit me shumice të cilësuar votash:

V E N D O S I:

1. Miratimin e ngastrës nr.13 në një sipërfaqe **Djerre prej 0.21 ha** në ekonomine pyjore Drin Gjadër Kirë për depozitim të materialeve inerte,zhure.
2. Afati i dhënies me qira të **jetë 1 vjeçar** sipas procedurave të ankandit e akeve ligjore në fuqi.
3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jete sipas VKM nr.1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.
4. Ky vendim hyn ne fuqi sipas parashikimeve të nenit 55,pika 6 e ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe konfirmimim ligjor të Prefektit të Qarkut Shkodër.
5. U shpall sot me date 29 . 10 2019

SEKRETARI  
Ardian Çelepija



KRYETARI  
Mark Bisha